

Bazuar në neni 8 të Ligjit të punës Nr. 03/L-212; nenin 18 të Ligjit Nr.08/L-305 për Ofruesin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror; Rregulloren për Marrëdhënien e Punës së Personelit të Ofruesit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror; Rregulloren për Pozitat e Punës, Përshkrimin e Vendeve të Punës dhe Kompensimin e Personelit të KANS si dhe në Procedurat për Rekrutimin e Kandidatëve për Student të Trafikut Ajror, Ofruesi i Shërbimeve të Navigacionit Ajror (KANS) për plotësim të vendit të lirë të punës si më poshtë, shpallë:

KONKURS PUBLIK

Institucioni: Ofruesi i Shërbimeve të Navigacionit Ajror - KANS

Titulli i vendit të punës: Kandidat -Student Kontrollor

Nr. referues: KANS/REK/001-2025

Njësia Organizative: Departamenti i Shërbimeve të Kontrollit Ajror

Numri i Pozitave: Dymbëdhjetë (12)

Procedura e aplikimit: E jashtme

Koeficienti: 2.12

Periudha e Kontratës: Me afat të caktuar

Kohëzgjatja e kontratës: Gjashtë (6) muaj, me mundësi vazhdimi

Afati për aplikim: 24.07.2025- 07.08.2025

Qëllimi i vendit të punës

- Aftësimi për licencim si Kontrollor i Trafikut Ajror.

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Mësimi i rregulloreve dhe standardeve të aviacionit civil;
- Kuptimi i procedurave të kontrollit të trafikut ajror (ATC);
- Studimi i navigacionit ajror, meteorologjisë, komunikimit dhe frazeologjisë standarde;
- Zbatimi i njohurive teorike në skenarë praktikë;
- Menaxhimi i trafikut ajror virtual në kushte të ndryshme;
- Mësimi i menaxhimit të situatave emergjente;
- Përdorimi i frazeologjisë së standardizuar të ICAO në komunikim me pilotët;
- Kalimi i provimeve teorike dhe praktike për të kaluar në fazat e ardhshme të trajnimit;
- Vlerësime psikologjike dhe të përqendrimit;
- Ruajtja e përqendrimit maksimal dhe profesionalizmit.

Kushtet e përgjithshme

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin përkatës për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të kenë nivelin e arsimit dhe përvojën e punës të kërkuar për pozitën;
- Të kalojnë me sukses procedurat e pranimit, sipas ligjit dhe akteve tjera të përcaktuara me ligj.

Kushtet e veçanta

- Të jetë i/e moshës nga 18 deri në moshën 25 vjeçare;
- Të ketë njohuri të avancuar të gjuhës angleze;
- Të ketë diplomë të shkollës së mesme.

Dokumentet e nevojshme për aplikim

- Formulari i aplikimit i plotësuar dhe i nënshkruar nga kandidati;
- Kopje e diplomës së Shkollës së Mesme;
- Kopje e ID (letërnjoftimi).

Dëshmitë që nuk kërkohen gjatë aplikimit, por në fazën e verifikimit para emërimit

- Çertifikatë mbi dënimet penale origjinale e lëshuar nga gjykata përmes së cilës dëshmohet se nuk është i/e dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Dëshmi përkatës se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar;
- Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publike apo një deklaratë se nuk ka masë disiplinore në fuqi për shkelje të rëndë në sektorin jo publik.

Vlerësimi dhe përzgjedhja e kandidatëve

- Testimi përzgjedhës përfshin testin me shkrim, intervistën dhe testimin profesional FEAST (First European Air Traffic Controller Selection Test);
- Faza e parë e vlerësimit bëhet përmes testimit me shkrim që do të organizohet në gjuhën angleze sipas praktikave evropiane të përshtatura për nevojat e KANS.
- Kriteri i kalueshmërisë së testimit me shkrim është pesëdhjetë 50 pikë nga 70, sa do të ketë gjithsej testi;

- Faza e dytë e vlerësimit bëhet përmes intervistimit të aplikantëve në gjuhën angleze që kanë kaluar me sukses fazën e parë;
- Vlerësimi i kandidatëve nga testimi me shkrim dhe intervistimi përmban gjithsej njëqind (100) pikë, shtatëdhjetë (70) pikë nga testimi me shkrim dhe tridhjetë (30) pikë nga intervista. Kalueshmëria është arritja e së paku shtatëdhjetë (70) pikëve nga dy fazat e testimit;
- Kandidatët që kalojnë me sukses fazën e testit me shkrim dhe intervistës do t'i nënshtrohen testimit profesional. Rezultati i fazës së parë dhe të dytë të testimit nuk përfshihet në rezultatet e testimit profesional;
- Vetëm pikët e fituara në testimin profesional – FEAST do të përcaktojnë kandidatët e përgjegjshëm për Kandidat – Student Kontrollor. Më shumë informata rreth FEAST mund të gjeni në linkun: <https://feast-info.eurocontrol.int/> ;
- Kandidatët e Suksesshëm do të përzgjidhen bazuar në renditjen e pikëve të fituara në përputhje me numrin e kërkuar sipas konkursit dhe të njëjtit do ti nënshtrohen kontrolleve mjekësore në AMC (Qendra e Mjekësisë së Aviacionit). Dështimi i kalimit të testeve shëndetësore diskualifikon kandidatët;
- Në rastet kur dy ose më tepër kandidat kanë pike të barabarta përparësi do të ketë kandidati me i ri në moshë;
- Kandidatët më të suksesshëm që kalojnë të gjitha testet do të dërgohen për shkollim në një institucion të certifikuar evropian.

Detyrimet e KANS ndaj Kandidatit Student Kontrollor

- KANS do të paguajë për shkollimin, akomodimin, ushqimin, sigurimin në udhëtim transportin në fillim dhe përfundim të trajnimit si dhe një rrugëtim vajtje/ardhje për në shtëpi gjatë kohës së trajnimit;
- Obligohet të paguajë pagë mujore;
- KANS nuk ka asnjë përgjegjësi kontraktuale ndaj nëpunësit që nuk mund të kalojë të gjitha fazat e trajnimit në licencim.

Detyrimet e Kandidatit - Student Kontrollor ndaj KANS

- Në rast të ndërprerjes së njëanshme të kontratës para marrjes së miratimit të parë (gjatë fazës së Shkollimit dhe Trajnimit në vend të punës), obligohet të paguajë të gjitha shpenzimet për përzgjedhjen dhe shkollimin e tij deri në atë moment;
- Obligohet të punojë në KANS për 7 (shtatë) vite pandërprerë, duke filluar nga data e licencimit me së paku një miratim (pas kalimit me sukses të shkollimit dhe trajnimit në vend të punës), përmes nënshkrimit të Kontratës me KANS;
- Në rast të shkëputjes së njëanshme të Kontratës nga ana e nëpunësit, nëpunësi detyrohet të paguajë shumën prej 100,000.00€ (njëqindmijë euro);

- Zotohet të ruajë kredibilitetin e KANS-së duke e përfaqësuar denjësisht atë në institutet e trajnimit dhe jo vetëm;
- Nëpunësi nuk ka përgjegjësi ndaj KANS-së në rast të dështimit për mbërritjen e standardeve të kërkuara, në secilën prej fazave të trajnimit.

Mënyra e aplikimit

- Të gjithë kandidatët e interesuar, aplikacionin për aplikim duhet ta shkarkojnë nga web-faqja zyrtare www.ashna-ks.org, dhe të plotësuar ta dërgojnë nëpërmjet adresës elektronike në email: kans.dbnj@rks-gov.net;
- Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen;
- Aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen;
- Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit dhe në faqen zyrtare të ASHNA-së, nga data 24.07.2025 deri më 07.08.2025 ora 23:59;
- Konkursi është i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi, ashtu siç parashihet me ligjin dhe aktet tjera në fuqi;
- Për më shumë informacione: Tel: 038 5958 521/520.

Njoftimi, komunikimi me kandidatët dhe shpallja e rezultateve përfundimtare

- Të gjitha njoftimet për kohën e testit, intervistës si dhe për rezultatet e secilës fazë të konkursit do të bëhen përmes faqes zyrtare të KANS www.ashna-ks.org ose përmes emailit dhe telefonit.

Sqarim shtesë

- Pas përzgjedhjes së kandidatëve fitues, njësia përgjegjëse bën verifikimin para emërimit me qëllim të vërtetimit se kandidatët vazhdojnë të plotësojnë kriteret e konkursit, përmes dokumenteve në original apo të njësuar me origjinalin.